



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

K.Dh.Sh.II.nr.1477/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS – Dhomat e Shkallës së Dytë, gjyqtari Krenar Berisha, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit Kompania Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike Sh.a (KESCO), me seli në Prishtinë, Bulevardi Bill Clinton, Nr.5, Ndërtesa Elektro Kosova, kundër debitorit “Baci” sh.a., me pronar E.L., rruga “Lidhja e Prizrenit”, nr.42 Prishtinë, për shkak të borxhit sipas dokumentit të besueshëm - ekstraktit të verifikuar nga librat afarist, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, KPPP.nr.156/23, të datës 15.05.2023, me datën 08.05.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pathemeltë ankesa e kreditorit Kompania Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike Sh.a (KESCO), me seli në Prishtinë, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, KPPP.nr.156/23, të datës 15.05.2023 VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, me aktvendimin e atakuar me ankesë, KPPP.nr.156/23, të datës 15.05.2023, e ka pranuar si të bazuar prapësimin e debitorit “Baci” sh.a., me pronar E.L. , rruga “Lidhja e Prizrenit”, nr.42 Prishtinë, është anuluar urdhri përmbarimor P.nr.246/2019 i datës 17.06.2019, i lejuar nga Përmbaruesi Privat Privat Driton Govori, me seli në Prishtinë, ashtu që është përfunduar në tërësi përmbarimi në këtë çështje përmbarimore.

Kundër aktvendimit të lartcekur, brenda afatit ligjor, ankesë ka parashtruar kreditori për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe përmbarimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe për shkak të zbatimit të gabuar të drejtës materiale, me propozimin që të aprovohet ankesa e kreditorit, të ndryshohet si i pabazuar aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë KPPP.nr.156/23, të datës 15.05.2023 ashtu që të mbetet në fuqi urdhri përmbarimor P.nr.246/19 i datës 17.06.2019 i Përmbaruesit Privat Driton Govori, me seli në Prishtinë, apo të prishet aktvendimi i atakuar dhe çështja t’i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rivendosje.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale - Dhomat e shkallës së Dytë, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore si dhe në kuptim të nenit 194 dhe 208 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) dhe gjeti se:

- Ankesa e kreditorit është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit Kompania Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike Sh.a (KESCO), me seli në Prishtinë, ka caktuar urdhrin përmbartimor P.nr.246/19 i datës 17.06.2019, duke lejuar përmbartimin në bazë të dokumenteve të besueshme - Ekstraktit nga Librat e Afariste DPR-..., për periudhën 27.04.2019 deri me datën 12.05.2019, me të cilin është urdhëruar debitori që në afatin prej 7 ditësh nga dita e pranimit të urdhrit, të paguajë shumën prej 885.19 € në emër të borxhit kryesor me kamatë 8%, nga dita e kalimit të afatit për pagesë deri në pagesën definitive të borxhit, në llogarinë bankare të kreditorit në BKT Bankë Nr....., me shenjën (DPR-...), si dhe shpenzimet e këtij ekzekutimi në llogarinë e përgjithshme të kreditorit në BKT Bankë Nr..... me shenjën (Taksa e Përmbartimit DPR-...), në të kundërtën, nën kërcënim të përmbartimit të dhunshëm, me ndalimin e mjeteve në para të cilat debitori i ka në llogarinë rrjedhëse, dhe bartjen e shumës përkatëse në llogarinë bankare të kreditorit, me ndalimin e mjeteve në të ardhura personale, ose përmes regjistrimit, sekuestrimit dhe të shitjes së sendeve të luajtshme të debitorit të cilat ndodhen në posedim të tij deri në vlerën e borxhit.

Kundër urdhrin për lejimin e përmbartimit, brenda afatit ligjor, debitori ka paraqitur prapësim, me të cilin e konteston në tërësi propozimin për përmbartim të kreditorit, duke theksuar se propozimi është i kundërligjshëm, pasi që konsiderohet se përmbartuesi privat me vetëdije e ka keqpërdorur detyrën e tij zyrtare dike tentuar të përfitoj përvete dhe për kreditorin, gjithashtu sipas kartelës se detyrimit monetar konstatohet se shuma e borxhit është 796.40 dhe jo 885.19 euro siç ka kërkuar kreditori. Debitori ka paguar rregullisht detyrimet ndaj kreditorit ku me datën 25.09.2018 borxhi i debitori është zero dhe pas kësaj date është paguar shuma prej 625.00 euro, prandaj debitori nuk ka obligim ligjor që ti paguaj të holla kreditorit dhe as shpenzimet e përmbartuesit privat. Andaj, ka propozuar që të aprovohet në tërësi si i themeltë prapësimi i debitorit, dhe të anulohet në tërësi si i pathemeltë Urdhri për Përmbartim P.nr.246/19 i datës 17.06.2019 i Përmbartuesit Privat Driton Govori, me seli në Prishtinë, për përmbartimin e borxhit në shumën prej 885.19 €, dhe abrogohen të gjitha veprimet e ndërmarra deri më tani në këtë çështje përmbartimore.

Në përgjigjen në prapësim kreditori, kundërshton pretendimet e debitorit si të pabazuara, se kreditori në mënyrë të rregullt ka bërë propozimin për përmbartim në bazë të dokumentit të besueshëm përkatësisht ekstrakti nga librat afarist duke u bazuar në nenin 29 par.1.2 e LPP-së. Periudhën për të cilën është dërguar për herën e parë në përmbartim, debitori e ka përmbush obligimin me datë 03.09.2018 ndërsa propozimi për përmbartim dhe urdhri përmbartimor i lejuar me datën 19.06.2018 ka të bëjë për periudhën prej 27.04.2019 deri 12.05.2019, andaj provat që

janë bashkangjitur në përgjigje në prapësim është vërtetuar gjendja reale dhe e plotë faktike, i propozon gjykatës që ta refuzoj prapësimin e debitorit si të pabazuar.

Duke vendosur sipas prapësimit Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë, me aktvendimin KPPP.nr.156/23, të datës 15.05.2023, e ka pranuar si të bazuar prapësimin e debitorit “Baci” sh.a., me pronar E.L. , rruga “Lidhja e Prizrenit”, nr.42 Prishtinë, është anuluar urdhri përmbartimor P.nr.246/2019 i datës 17.06.2019, i lejuar nga Përmbartuesi Privat Driton Govori, me seli në Prishtinë, ashtu që është përfunduar në tërësi përmbartimi në këtë çështje përmbartimore. Në arsyetim të vendimit theksohet se dokumenti i besueshëm-ekstrakti i verifikuar nga librat afarist DPR nr...., në bazë të cilit është lejuar urdhri për përmbartim nuk i plotëson kriteret e parapara me nenin 29 dhe 37 të LPP-së. Në rastin konkret shuma e kërkuar në propozim për përmbartim është në vlerë prej 886.19€ për periudhën kohore 27.04.2019 deri 12.05.2019 ndërsa shuma e treguar në dokumentin e besueshëm për periudhën 27.04.2019 deri 12.05.2019 është në vlerë 185.50€, pres së cilës rezulton se debitori ka paguar vlerën prej 180.00€ dhe rrjedhimisht borxhi i kërkuar nga kreditori nuk përputhet me dokumentin në bazë të cilit është lejuar urdhri për përmbartim.

Gjykata Komerciale - Dhomat e Shkallës së Dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë në bazë të provave të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës, në bazë të vërejtjeve të Aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës-Dhomat e shkallës së dytë, K.Dh.SH.II nr.1384/22 të datës 19.01.2023, ka marr aktvendimin e saj të drejtë dhe të bazuar në dispozitat e procedurës përmbartimore.

Vlerësimin dhe qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhomat e Shkallës së Dytë, e aprovon si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se aktvendimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 1 dhe 2 të LPK-së, dhe se drejtë është zbatuar e drejta materiale, e të cilat shkaqe ankimore gjykata e shkallës së dytë, në bazë të nenit 194 të LPK-së, i vlerëson edhe sipas detyrës zyrtare.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata Komerciale – Dhoma e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përmbartimore me rastin e vendosjes për aprovim të prapësimit të debitorit. Sipas vlerësimit të kësaj gjykate, gjykata e shkallës së parë drejtë, ka vlerësuar drejt gjendjen faktike kur ka konstatuar se dokumenti i besueshëm – ekstrakti nga librat afarist nuk i plotëson kushtet e parapara me nenin 29 dhe 37 të LPP-së, ngase nuk përmban detyrimin e saktë, ku sipas dokumentit në bazë të se cilës është lejuar urdhëri përmbartimor për periudhën 27.04.2019 e deri me datën 12.05.2019 borxhi figuron në shumë prej 185.50, ku debitori ka paguar vlerën prej 180.00 euro, ndërsa në propozim borxhin kreditori që ka kërkuar është 885.19, pra kemi mos përputhje mes propozimit dhe dokumentit që është lejuar urdhëri përmbartimor. Në këtë drejtim gjykata e shkallës së parë drejtë ka zbatuar kushtet ligjore nga Neni 29 par.1 të LPP, i cili përcakton se “ *Përmbartimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm. Dokument i besueshëm, sipas këtij ligji është: 1.1. kambialet dhe çeqet me potest dhe faturë*

kthyesë, po që se janë të nevojshme për themelimin e kërkesës; 1.2. ekstraktet e verifikuara nga librat afariste për pagesat e shërbimeve komunale të furnizimit me ujë, energji elektrike dhe bartjen e mbeturinave; 1.3. faturat; 1.4. dokumentet që sipas dispozitave ligjore të posaçme kanë rëndësinë e dokumenteve publike”, sipas nenin 29 par. 3 të LPP i cili përcakton se “Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbartim po që se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”, ndërsa me nenin 37 të LPP është përcaktuar se “Kur propozimi për përmbartim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit”.

Mbi bazën e kësaj dispozite ligjore, kjo Gjykatë vlerëson se gjykata e shkallës së parë ka konstatuar drejtë se dokumenti i besueshëm mbi të cilën ishte iniciuar procedura përmbartimore, respektivisht është lejuar përmbartimi nuk i plotëson kushtet në mënyrë kumulative që duhet t’i ketë dokumenti i besueshëm. Në rastin konkret është edhe qëndrim i kësaj gjykate se qartë rezulton se nuk përmban detyrimin e saktë, ku sipas dokumente në bazë të se cilës është lejuar urdhëri përmbartimor për periudhën 27.04.2019 e deri me datën 12.05.2019 borxhi figuron në shumë prej 185.50, ku debitori ka paguar vlerën prej 180.00 euro, ndërsa në propozim borxhin kreditori që ka kërkuar është 885.19€, pra kemi mos përputhje mes propozimit dhe dokumentit që është lejuar urdhëri përmbartimor. Së këndejmi, Dhoma e Shkallës së Dytë e Gjykatës Komerciale vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejtë ka vlerësuar gjendjen faktike dhe nuk ka vepruar me shkelje të dispozitave me rastin e vendosjes si në aktvendimin e atakuar.

Andaj, duke marr parasysh pretendimet ankimore, të cilat konsistojnë ndaj aktvendimit të ankimuar, Gjykata Komerciale e Kosovës - Dhomat e Shkallës së Dytë konsideron se këto pretendimet ankimore janë të pa bazuara, ngase nuk kemi të bëjmë me shkelje thelbësore të dispozitave të Ligjit të Procedurës Kontestimore, dhe zbatimin të gabuar të se drejtës materiale, të cilat shkelje kjo gjykatë i vështron sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së, dhe as të Ligjit të Procedurës Përmbartimore.

Nga arsyet e paraqitura me lartë, Dhomat e shkallës së dytë vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi në pajtim me nenin 208 dhe 209 pika b) të LPK-së, e lidhur me nenin 17 dhe 77 të LPP-së.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhomat e shkallës së dytë
K.Dh.Sh.II.nr.1477/23 me datë 08.05.2024

Gjyqtari,
Krenar Berisha